

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Venhar Salihu, në çështjen kontestimore të paditësit _____ nga fsh. _____, Komuna e Kamenicës, tani me vendbanim në _____, Rr.” _____”, nr. _____, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson _____, jurist nga Gjilani, kundër të paditurës _____, (_____) nga fshati _____, Komuna e _____, tani me vendbanim në _____, Rr.” _____”, nr.101 të cilën e përfaqëson _____ jurist nga Gjilani, me objekt kontesti vërtetimi i të drejtës së pronësisë, jashtë seancës gjyqësore, më dt. 26.11.2018, merr këtë:

AKTGJYKIM

-në bazë të pohimit-

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit _____ nga _____, e paraqitur kundër të paditurës _____ (_____) nga _____ i me objekt kontesti vërtetimi i të drejtës së pronësisë dhe VËRTETOHET se paditësi, në bazë të parashkrimit fitues është pronar i ngastrave kadastrale kadastrale numër _____, në sipërfaqe prej 1582m², ngastrës kadastrale numër _____, në sipërfaqe prej 1572 m², ngastrën kadastrale numër _____, në sipërfaqe prej 1552m², ngastra këto të cilat gjinden në Zonën Kadastrale Gjilan dhe evidentohen në emër të _____ dhe _____.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m i

Paditësi, në këtë gjykatë përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, më dt. 15.09.2015, ka paraqitur padi kundër të paditurës, me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë. I njëjti në padi ka theksuar se në bazë të kontratës verbale në vitin 1985 nga babai dhe nëna e të paditurës ka blerë tri ngastrat kadastrale edhe atë: P- _____, në vendin e quajtur “ _____ ” në sipërfaqe prej 1582m², P- _____ në vendin e quajtur “ _____ ” në sipërfaqe prej 1572m² ZK Gjilan të evidentuara në Certifikatën e pronës në numrin e lëndës _____, të evidentuara në emër të _____ dhe njësia kadastrale P- _____, e evidentuar në emër të _____, në vendin e quajtur “ _____ ” në sipërfaqe prej 1552m², në çmim të përgjithshëm prej 33.000 DM (tridhjetë e tre mijë marka gjermane), ku i njëjti pas pagesës së çmimit, paraardhësve tani të paditurës dhe që nga ajo kohë i njëjti ka hyrë në posedim me mirëbesim të ligjshëm dhe në shfrytëzim të pa ndërprerë mbi 30 viteve të këtyre parcelave.

E paditura, në përgjigjen në padi më dt.23.02.2017, ka deklaruar se e pranon padinë e paditësit si të bazuar, pasi që gjendja faktike e paraqitur në padi është e vërtetë dhe e saktë dhe se sipas saj nuk janë kontestuese paluajtshmëritë e cekura më lartë në padi, sepse është e vërtetë se babai i saj _____ në vitin 1985 ia ka shitur këto parcela _____ ashtu që paditësi ua kishte paguar edhe çmimin e shitblerjes e që tani të njëjtës nuk i kujtohet sa ka qenë ai çmim por që e din se nuk iu ka mbetur borxh, si dhe që nga ajo kohë blerësi tani paditësi e ka

¹ Në emër të _____, evidentohen ngastrat kadastrale nr. _____ dhe _____, kurse në emër të _____ evidentohet ngastra numër _____.

marrë në posedim dhe ata nuk e kanë penguar asnjëherë sepse parcelat janë të tijat. Andaj e njëjta i ka propozuar kësaj gjykate që të nxjerrë aktgjykim në bazë të pohimit.

Gjykata në lidhje me këtë çështje ka caktuar seancën përgatitore dhe aty prezent kanë qenë i autorizuari i paditësit dhe i autorizuari i të paditurës ku ky i fundit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi me të cilën e paditura e ka pohuar kërkesëpadinë e paditësit dhe i njëjti ka biseduar edhe personalisht me të paditurën dhe e ka njoftuar se ngastrat kontestuese babai dhe nëna e të njëjtës ia ka shitur në vitin 1985 tani paditësit.

Të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse gjykatës si provë i kanë paraqitur Certifikaten e vdekjes; Aktvdekjen për _____ dhe _____ (prindërit biologjik të të paditurës, ku është vërtetuar se të njëjtit kanë vdekur dhe si trashëgimtare të vetme kanë lënë tani të paditurën); Certifikaten e lindjes në emër të _____ (ku është vërtetuar se e njëjta si prindër biologjik i ka pronarët juridik të ngastrave kontestuese). Gjithashtu të njëjtit gjykatës i kanë paraqitur edhe vërtetimin e identitetit edhe atë për të ndjerin _____ me të cilin është vërtetuar se ky i fundit është i njëjti person me _____ (pronar juridik i ngastrave nr. _____ dhe _____) kurse me vërtetimin tjetër në emër të _____ gjykata vërtetoi se është e njëjta person me _____ (gruaja e _____ dhe pronare juridike e ngastrës _____). Nga Certifikatat e pronës të lëshuara nga DGJKP-ja në Gjiilan më dt.12.11.2018 shihet se si pronar juridik janë prindërit biologjik të të paditurës.

Meqenëse e paditura e ka pohuar kërkesëpadinë e paditësit dhe gjykata nga dokumentet e paraqitura u vërtetua se e njëjta është trashëgimtare e vetme e pronarëve juridik të ngastrave kontestuese dhe e bindur se në rastin konkret e paditura dhe paditësi disponon me të drejtat juridiko – civile dhe kërkesat e paraqitura në këtë procedurë siç ka paraparë neni 3 i LPK-së dhe në rastin konkret kjo gjykatë vërtetoi se kërkesat juridiko – civile të palëve ndërgjyqëse nuk janë në kundërshtim me rendin juridik, dispozitat ligjore dhe rregullat e moralit publik andaj nga këto arsye në njërin anë, kurse në anën tjetër duke u bazuar në nenin 148 të LPK-së vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së, pasi që asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk i kërkoi shpenzimet e kësaj procedure.

Andaj nga të lartcekurat, duke përfshirë gjendjen faktike, dispozitat ligjore si më lart, bindjen e lire të gjyqtarit të çështjes dhe lidhur me nenin 142 pika 1 dhe 2 dhe 143 pika 1 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari,
Venhar Salihu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të të njëjtit, vetëm për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj gjykate.